- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'ë realizojmë për Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), punimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në preventiv, me të gjitha projektet teknike, e me kërkesat në detyrën e projektimit apo termat e referencës, nëse është rasti, dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontrates;
 - 3. Kriteret e Vlerësimit;
 - 4. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 5. Specifikimet teknike, Projektet dhe çdo dokumentacion teknik;
 - 6. Preventivin e çmimeve
 - 7. Termat e referencës (nëse është rasti)
 - 8. Detyrën e projektimit (nëse është rasti)
 - 9. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 10. Kushtet e Veçanta të Kontratës;

- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë]

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	

Shtojca 2.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ZËRAVE TË PREVENTIVIT****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** _____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë zërave në Formularin e listës së çmimeve sipas zërave të preventivit dhe grafikut të realizimit të punimeve duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar për secilin zë në preventiv. Zërat e preventivit pa çmim do të konsiderohen si zëra të paofertuar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

Oferta ekonomike e detajuar

Nr	Nr. Analizë	Përshkrimi i Punëve	Njësi	Sasia	Çmimi/ Njësi	Cmimi total
1.						
2.						
3.						
Shuma						
Fondi Rezervë						
Shuma						
TVSH						
SHUMA TOTAL						

Nënshkrimi i ofertuesit _____**Vula****Shënim:** Çmimet duhet të shprehen në Monedhën ____ (e kërkuar në dokumentat e tenderit)

Shtojca 3.

[*Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik*)

[*Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve*]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [*Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor*]

Në emër të: [*Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar*]

* * *

Procedura e prokurimit [*lloji i procedurës*]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [*objekti*]

Publikimi (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike [*Data*] [*Numri*] / Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [*emri i autoritetit /entit kontraktor*] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [*njoftimin e kontratës*].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit**Nënshkrimi****Vula**

Shtojca 5.

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor*]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Të dhënat teknike të punëve objekt prokurimi duhet të përshkruhen sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

SHËNIM: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

GRAFIKUT I ZBATIMIT TË PUNIMEVE

Afatet e realizimit të punimeve:

Nr	Emertimi	Njesia		MUAJI 1				MUAJI 2				MUAJI 3				
				Java 1	Java 2	Java 3	Java 4	Java 5	Java 6	Java 7	Java 8	Java 9	Java 10	Java 11	Java 12	Java 13
1	Punime mobilizimi	dp	6													
2	Punime Prishje Demolition Works	m2	22													
3	Punime Gërmimi	m3	3													
4	Punime Betoni dhe B/a e hekuri	m3	9													
5	Punime tarrace	m2	17													
6	Punime shtresash	m2	12													
7	Punime suvatimi e bojatisjeje të brendëshme	m2	11													
8	Punime dyersh e dritaresh <i>Doors and window works</i>	m2	3													
9	Punime te jashtme <i>Outdoor works</i>	m2	14													
10	Punime te sistemimit te jashtem <i>Outdorr site works</i>	m2	32													
11	Punime Hidrosanitare Sanitary Works	m2	10													
12	Punime kanalizimi	m1	3													
13	Sistemi I ngrohjes Heating system	m2	4													
14	Punime elektrike	m2	15													
15	Punime dorezimi	dp	6													

Shënim. Autoriteti/enti kontraktor mund të shtojë rreshta në varësi të zërave të punimeve dhe kollona në varësi të afatit të parashikuar për realizimin e tyre.

Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojces 8.

Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2018, 2019, 2020, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 12.568.796,05 (dymbëdhjetë milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e gjashtë pikë zero pesë) lek.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2019, 2020, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të ligjit nr.10091 datë 5.3.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

2.2.3. Vërtetim lëshuar për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2021, kudo ku operatori ushtron aktivitet, sipas regjistrimit në QKB, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për vitin 2021.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është rregjistruar sipas QKB-se).

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi fitues përpara dhënies së kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës,

ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë si dhe dokumentat e mëposhtëm:

- i. Kontratën e Sipërmarrjes,
- ii. Situacion përfundimtar të objektit,
- iii. Aktin e Kolaudimit të objektit,
- iv. Formular Vlerësimi nga Investitori sipas Shtojcës nr.9

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve si dhe dokumentat e mëposhtëm:

- i. Kontratën e Sipërmarrjes,
- ii. Situacion përfundimtar të objektit,
- iii. Aktin e Kolaudimit të objektit,

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturas dhe Energjise, ne baze te VKM Nr 42 dt 16.01.2008 i ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

- a. NP-1: Punime germimi ne toke "Kategoria A".
- b. NP-2: Ndertimi civile dhe industriale "Kategoria A"
- c. NP-3: Rikonstruksion dhe mirembajtje godinash civile dhe industriale, veshje fasada. "Kategoria A"
- d. NS-1: Punime për prishjen e ndërtimeve "Kategoria A"
- e. NS-2: Impiante hidro-termosanitare dhe mirembajtja e tyre. "Kategoria A"

- f. NS-4: Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to etj. “Kategoria A”
 g. NS-12: Impiante teknologjike, termike dhe te kondicionimit “Kategoria A”
 h. NS-14: Impiante te brendeshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni, TV etj. “Kategoria A”

Ne rast bashkimi operatoresh secili duhet te disponoje kategorite e licences sipas marreveshjes se bashkepunimit.

➤ **NP-1: Punime gërmimi në tokë** “Kategoria A”

Konsiderohen gërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjete, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gërmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.

➤ **NP-2: Ndertimi civile dhe industriale** “Kategoria A”

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta në objekte ku zhvillohen aktivitete njerëzore të drejtpërdrejta ose jo, kompletimi me strukturat e nevojshme dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar godina banimi, shkolla, zyra, kazerma ushtrie, teatro, stadiume, godina industriale, godina për parkim, burgje, stacione hekurudhore dhe metroje, godina aeroporti me ndonjë punim special në betonarme të thjeshtë ose të paranderur, betonim të tavaneve të hollë, membrana, kupola, depozita të varura, sillos dhe ndërtime të larta me strukturë me karakteristika të veçanta e komplekse.

➤ **NP-3: Rikonstruksion dhe mirembajtje godinash civile dhe industriale, veshje fasada.** “Kategoria A”

Konsiderohen zgjidhjet dhe koordinimi i punimeve të specialiteteve të nevojshme për riaftësim, konservim, konsolidim, transformim, rivlerësim, ristrukturim. Konsiderohen gjithashtu dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje..

➤ **N.S. 1: Punime për prishjen e ndërtimeve** “Kategoria A”

Konsiderohet çmontimi i impianteve industriale dhe prishja komplet e ndërtesave me pajisje speciale ose me përdorim eksplozivi me prerje të strukturave betonarmeje dhe prishjeve në përgjithësi përfshi edhe grumbullimin e mbeturinave, ndarjen e tyre dhe riciklimin e materialeve.

➤ **NS-2: Impiante hidro-termosanitare dhe mirembajtja e tyre.** “Kategoria A”

Konsiderohet, montimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i impianteve hidrosanitare të kuzhinës, lavanterisë së gazit dhe kundër zjarrit, sado që të jetë shkalla e rëndësisë së veprave, e kompletuar me punimet e muraturës plotësuese ose ndihmëse, që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.

➤ **NS-4: Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to etj.** “Kategoria A”

Konsiderohet ndërtimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i muraturës dhe mureve ndarës të çfarëdo lloji, tipi, përfshirë suvatimin, patinimin, bojatisjen dhe punime të ngjashme me to.

Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i karpenterisë dhe punimeve prej druri, të dyerve dhe dritareve të brendshme dhe të jashtme, të veshjeve të brendshme dhe të jashtme të dyshemeve të tipeve të ndryshme dhe me materiale të ndryshme dhe të punimeve të realizuara me dorë, me metal, dru, material plastik dhe material xhami ose të ngjashëm.

Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i izolimit termik dhe akustik, nënçatitë dhe mbrojtja nga zjarri, izolimi i natyrave të ndryshme dhe me materiale të ndryshme.

➤ **NS-12 Impiante teknologjik, termike dhe te kondicionimit** "Kategoria A"

Konsiderohen montimi dhe mirëmbajtje ose ristrukturimi i një sistemi të plotë, sido që të jetë shkalla e rëndësisë së tyre, të ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit të klimës, të impianteve pneumatike, të kompletuara me punimet murature, plotësuese ose ndihmëse, për të realizuar bashkimet ose ndërhyrjet që i përkasin kategorive të përgjithshme që janë realizuar ose janë në proces realizimi.

➤ **NS-14: Impiante te brendeshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni, TV etj.**

"Kategoria A"

Konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave elektrike, telefonike, radiotelefoni e TV, si edhe të linjave të transmetimit të ngjashme me to, të kompletuar me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për t'u realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- | | |
|--------------------------|---------|
| a. Inxhinier ndertimi | 1 (nje) |
| b. Inxhinier hidroteknik | 1 (nje) |
| c. Inxhinier elektrik | 1 (nje) |
| d. Inxhinier mekanik | 1 (nje) |

Per kete duhet te paraqes Diplome, CV (e kompletuar me te gjithë kontaktet, kompanit ku ka punuar, pikat e kontaktit, pershkimin e punes qe ka kryer), certifikata/referenca te trajnimeve apo deshmive qe ai ka performuar me suksese detyrat e dhena, kontrate bashkepunim/pune te vlefshme ose deklarate disponibiliteti dhe eskuziviteti, dhe te figuroj ne listpagesen e shoqerise nga muaji Gusht 2021 e ne vazhdim.

Shënim: Ky dokumentacion do të paraqitet nga operatori ekonomik fitues para Lidhjes së kontratës ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK, pasi kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

2.3.4. Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe **stafin mbështetës** (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- | | |
|-------------|---------|
| a. Topograf | 1 (nje) |
|-------------|---------|

Per kete duhet te paraqes Diplome, License Profesionale, CV (e kompletuar me te gjithë kontaktet, kompanit ku ka punuar, pikat e kontaktit, pershkimin e punes qe ka kryer), certifikata/referenca te trajnimeve apo deshmive qe ai ka performuar me suksese detyrat e dhena, kontrate bashkepunim/pune te vlefshme ose deklarate disponibiliteti dhe eskuziviteti, dhe te figuroj ne listpagesen e shoqerise nga muaji Gusht 2021 e ne vazhdim.

Shënim: Ky dokumentacion do të paraqitet nga operatori ekonomik fitues para Lidhjes së kontratës ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK, pasi kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

2.3.5. Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si më poshtë:

- a. **Teknike ndertimi 2 (dy)** per kete duhet te paraqes Diplome te shkolles se mesme, kontrate pune te vlefshme , deshmi kualifikimi të sigurimit teknik (te vlefshme) IQT (ose ekuivalente), dhe te figurojn ne listpagesen e shoqerise nga muaji Gusht 2021 e ne vazhdim.
- b. **Specialiste 12 (dymbedhete)** per kete duhet te paraqes, kontrate pune te vlefshme, deshmi kualifikimi të sigurimit teknik (te vlefshme) IQT (ose ekuivalente) , dhe te figuroj ne listpagesen e shoqerise nga muaji Gusht 2021 e ne vazhdim.
Specialistet do te jene sipas ndarjes mëposhtë:

- **Suvatues 4 (kater)**
- **Pllakashtrues 4 (kater)**
- **Bojaxhinj 4 (kater)**

- c. **Puntore te thjeshte 12 (dymbedhete)** per kete duhet te paraqes, kontrate pune te vlefshme, dhe te figurojn ne listpagesen e shoqerise nga muaji Gusht 2021 e ne vazhdim e ne vazhdim.
- d. **Elektriciste 4 (kater)** per kete duhet te paraqes, kontrate pune te vlefshme, deshmi kualifikimi të sigurimit teknik (te vlefshme) IQT (ose ekuivalente) , dhe te figuroj ne listpagesen e shoqerise nga muaji Gusht 2021 e ne vazhdim.
- e. **Hidraulike 2 (dy)** per kete duhet te paraqes, kontrate pune te vlefshme, deshmi kualifikimi të sigurimit teknik (te vlefshme) IQT (ose ekuivalente), dhe te figurojn ne listpagesen e shoqerise nga muaji Gusht 2021 e ne vazhdim.
- f. **Specialist ngrohje-kondicionimi 2 (dy)** per kete duhet te paraqes, kontrate bashkepunim/pune te vlefshme ose deklarate disponibiliteti dhe eskuziviteti, deshmi kualifikimi të sigurimit teknik (te vlefshme) IQT (ose ekuivalente), dhe te figurojn ne listpagesen e shoqerise nga muaji Gusht 2021 e ne vazhdim.
- g. **Shofere 2 (dy)** per kete duhet te paraqes, kontrate pune te vlefshme leje drejtimi, deshmi kualifikimi të sigurimit teknik (te vlefshme) IQT (ose ekuivalente), dhe te figurojn ne listpagesen e shoqerise nga muaji Gusht 2021 e ne vazhdim.
(Ne raste kur makinerit disponohen me qera, keta punonjes mund te jene te kontraktuar.)
- h. **Manovratore 2 (dy)** per kete duhet te paraqes, kontrate pune te vlefshme leje drejtimi, deshmi kualifikimi të sigurimit teknik (te vlefshme) IQT (ose ekuivalente) dhe te figurojn ne listpagesen e shoqerise nga muaji Gusht 2021 e ne vazhdim.
- i. (Ne raste kur makinerit disponohen me qera, keta punonjes mund te jene te kontraktuar.)

Shënim: Ky dokumentacion do të paraqitet nga operatori ekonomik fitues para Lidhjes së kontratës ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK, pasi kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

2.3.6. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 43 (dyzet e tre) persona**. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të

punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Dokumentat për të vërtetuar këtë kriter janë:

- a) *Vertetim të leshuar nga Dega e Tatimeve të Rrethit ose nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore të rrethit perkates ose me vule elektronike .*
- b) *Listepagesat për periudhën e mesipërme (E-sig 25)*

Shënim: Ky dokumentacion do të paraqitet nga operatori ekonomik fitues para Lidhjes së kontratës ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK, pasi kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Shënim: Argumentimi mbi numrin e punonjësve.

Ne objektin **“Rikonstrukcion i qendres shëndetësore në Ruzhdie dhe ambulances në Dukas-Çoban”** proceset e punës klasifikohen në këto kategori:

a) Punime për mobilizimin e kantierit

Ne këto punime përfshihet përgatitja e kantierit për fillimin e punimeve. Gjate kësaj kohe do të përcaktohen furnitorët dhe vendet e depozitimit të materialit. Do të stukturrohet organika e njerezve që do të punojnë në kantier dhe do të bëhet konturimi i kantierit me hyrje-daljet e tij. Afati i parashikuar 6 ditë kalendarike. Puntore të angazhuara: 2 specialiste, 2 puntore. Makineri Kamioçine dhe/ose pick-up.

b) Punime prishjeje

Afati për punimet e prishjeve është parashikuar 22 ditë punë për qendrën shëndetësore në Ruzhdie dhe 19 ditë punë për ambulance në Dukas Coban. Volumi i punimeve: ~145 m³.materile si suvatime, dyer dritare shtresat e tarraces etj Puntore të angazhuara:2+2 specialist +8+8 puntore. Mjete të angazhuara: 4 matrapik, 4 karro dore, 2 kamioçine.

c) Punime Betoni e b/a dhe hekuri

Afati i parashikuar për punimet e muratës është 9 dp për të dy objektet. Për realizimin e të gjithë volumit të punimeve duhen 4 specialiste + 4 puntore. Makineri dhe mjete në dispozicion: 2 betoniere, 2 depozite uji, 4 karro dore, 2 trako hekuri, 2 gjeneratorë, skela muratori, 2 matrapik.

d) Punime tarrace

Sipërfaqja e tarraces është 270 m². Për realizimin e këtyre punimeve është parashikuar afati prej 23 ditësh. Për realizimin e të gjithë volumit të punimeve duhen:4 specialiste dhe 2 puntore. Makineri dhe pajisje të angazhuara: 1 betoniere, 1 depozite uji, 2 karro dore, 1 trako hekuri, skela muratori, matrapik, 1 kamioçine.

e) Punime shtresa e veshje me pllaka

Parashikimi për këto kategori punimesh shkon në 4811 ore punë ose 601.4 ditë punë. Referuar normative për m² (përfshirë shtresa, nënshtresa dhe veshje) 10,128 ore/m² , koha totale e punës shkon në 4811 ore. Referuar Kohës ditore prej 8 orësh, ekuivalentohet në 601.4 ditë. Për afat prej 40 ditësh , duhen 15-fishuar fuqia puntore dhe mjetet , kundrejt sasise nominale. Përfundimisht për këto proces punë, brenda afateve duhen 8 specialist + 4 puntore. Makineri dhe mjete të angazhuara për

kete proces pune: prerese pllakash qeramike, 1 trako, 1 trapano, 1 betoniere, 1 depozite uji, 1 kamiocine.

f) Punime suvatimi me volum mesatar 1531 m2.

Per te perfunduar kete kategori punimesh, per te gjithë volumit e kerkuar duhen 5497 ore pune. Referuar normativave per m2 duhen 3.59ore/m2. Gjithesej duhen 5497 ore pune ose 687 dite pune. Afati I perfundimit te punimeve per kategorine e punimeve te suvatimit eshte parashikuar 29 dite pune. Per realizimin e ketyre afateve nevojiten per punimet e suvatimit 12 sp + 12puntore. Makineri dhe mjete ne dispozicion: 1 betoniere, 1 depozite uji, skele muratori, 1 kamiocine.

g) Punime dyer dritare

Parashikimi per kete kategori punimesh shkon ne 464 ore pune ose 58 dite pune. Referuar normative per m2 duhen 1.6 ore/m2 , koha totale e punes shkon ne 464 ore. Referuar Kohes ditore prej 8 oresh, ekuivalentohet ne 58 dite. Per afat prej 10 ditesh , duhen 6-fishuar fuqia puntore dhe mjetet, kundrejt sasise nominale. Perfundimisht per kete proces pune, brenda afateve duhen 4 specialist + 2 puntore. Makineri dhe mjete te angazhuara per kete proces pune: 1 trapano, 1 kamiocine.

h) Punime bojatisje dhe punime te ndryshme

Per kete kategori punimesh parashikimi shkon ne 1722 ore pune ose 216 dite pune. Referuar normes ditore prej 8 ore pune, norma orare eshte 0.87 ore/m2. Per realizimin e punimeve ne afatin 15 dite pune duhen angazhuar 8 specialiste dhe 7 puntore. Makineri dhe mjete ne nevojshme per kete kategori pune jane: 1 kamiocine, 1 betoniere, skele inventari, depozite uji.

i) Punime instalime hidrosanitare

Ne kete kategori punimesh perfshihen nje sere zerash si: shtrimi i tubove dhe linjave hidraulike dhe montimi e vendosja e pajisjeve te hidrosanitare ne ambientet e reja te tualeteve. Ne kete proces pune duhet te angazhohen 2 hidraulike + 1 1 puntore. Ne total eshte parashikuar qe keto punime te zgjasin rreth 12 dite pune. Per realizimin e punimeve brenda ketyre afateve duhen a 2 hidraulike + 1 puntore.

j) Punime MNZ

Ne kate kategori punimesh perfshihen, linjat e sistemit te mbrojtjes nga zjarri dhe rreziku me te gjithë aksesoret e nevojshem si edhe aparaturat perkatese. Per kete proces pune nevojiten: 2 specialiste dhe 1 puntor. Koha e parashikuar per realizimin e punimeve eshte 5 dite pune. Per realizimin e punimeve nevojiten keto makineri e pajisje: 1 kamiocine, 1 trapano, 1 trako.

k) Punime te sistemimit te jashtem

Per realizimin e punimeve te sistemimit te jashtem duhen 4346 ore pune ose 543 dp. Afati i parashikuar per kryerjen e ketyre punimeve eshte 36 dite. Per realizimin ne afat te punimeve duhet 15 fishuar fuqia puntore. Ne total per realizimin e ketyre punimeve brenda afatit kohor prej 36 ditesh duhen 7 specialiste dhe 8 puntore. Makineri dhe pajisje te nevojshme per realizimin e punimeve: 1 kamion, 1 minifadrom, 1 kamioncine dhe 1 betoniere+1 vibrator betoni.

l) Punime instalime elektrike.

Ne kete kategori punimesh perfshihen nje sere zerash si: shtrimi i tubove dhe linjave elektrike dhe vendosja e pajisjeve te ndricimit ne te gjithë ambientete e nen rikonstruktim. Ne kete proces pune

duhet te angazhohen 2 elektrikiste + 1 specialist + 1 puntore. Ne total eshte parashikuar qe keto punime te zgjasin rreth 27 dite pune. Per realizimin e punimeve brenda ketyre afateve duhen a 2 elektrikiste + 1 specialist + 1 puntore.

m) Punime instalime mekanike (sistemi i ngrohjes)

Per punimet e kategorise se instalimeve mekanike septike nevojiten 1164 ore pune ose 145.5 dp Afati I perfundimit te punimeve per keto punime eshte 29 dite pune. Per realizimin e punimeve brenda ketyre afateve duhet 5-fishuar fuqia puntore. Per realizimin ne afatin e kerkuar duhen angazhuar 4 specialiste+1 punterore. Makineri dhe mjete te angazhuara per kete proces pune: 1 kamiocone, 1 mastrapik, 1 trako.

Referuar kategorise se punimeve si dhe afatit, stafi i kerkuar duhet te jete:

- Teknike ndertimi 2 (dy)
- Specialiste
(suvatues 4; pllakashtrues 4; bojaxhinj 4) 12 (dymbedhjete)
- Elektriciste 4(kater)
- Hidraulike 2 (dy)
- Specialist ngrohje-kondicionimi 2 (dy)
- Puntore te thjeshte 12 (dymbedhjete)
- Shofere 2 (dy)
- Manovratore 2 (dy)
- Topograf 1(nje)
- Drejtues Teknik 4 (kater)

TOTALI = 43 Persona ne Staf.

Shenim: Argumetnimi i nr. te punonjeseve behet vetem me qellim per justifikimin e stafit te kerkuar. Ndarrja sipas specialitetev ne kete rubrike te mos merret ne konsiderate ne plotesimin e kriterëve te percaktuara.

2.3.7. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

- **Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes (8t deri ne 10 ton) cope 2 (dy)**
- **Kamiocone me kapacitet mbajtes 3.5t - 4.0 ton cope 2 (dy)**
- **Mini Fadrome cope 2 (dy)**
- **Betoniere cope 2 (dy)**
- **Depozite uji deri ne 10 000 Litra cope 2 (dy)**
- **Vibrator betoni cope 2 (dy)**
- **Matrapik cope 2 (dy)**
- **Kontenier per depozitim dhe grumbullimin e materialeve cope 2 (nje)**
- **Gjenerator 3.5kW cope 2 (nje)**

Pranohet marrja me qera e mjeteve të mësipërme, me kusht që kontrata e qeramarrjes të jetë bërë para noterit, me afat vlefshmërie brenda afatit të zbatimit të punimeve për këtë objekt.

Ofertuesi për makineritë, të cilat janë në pronësi ose me qera, duhet të paraqesë, dokumentacionin e mëposhtem:

- lejen e qarkullimit.
- certifikatat e pronësisë,
- siguracionin e mjetit.
- kolaudimin,
- certifikatë transporti
- fotografi të mjetit të paraqitura. (të cilat duhet të jenë në emër të shoqërisë ose në emër të qeradhënësit).

Për mjetet dhe pajisjet të cilat nuk kanë leje qarkullimi, Ofertuesi duhet të paraqesë:

- kontratë noteriale të blerjes,
 - fatura tatimore të blerjes ose dokumenta zhdoganimi të mjetit.
- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit, leje qarkullimi, plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), dhe për mjetet e siguruara me qera, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij, leje qarkullimi, plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit,(të vlefshme), të shoqëruar me kontratën përkatëse të qerasë/furnizimit noteriale,, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekti i këtij prokurimi.*
- b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.*

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Shënim: Ky dokumentacion do të paraqitet nga operatori ekonomik fitues para Lidhjes së kontratës ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK, pasi kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

2.3.8. Mbështetur në:

Ligj Nr. 9010, date 13.02.2003 Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta, Ndryshuar me Ligjin Nr 10137, date 11.05.2009 PER DISA NDRYSHIME NE LEGJISLACIONIN NE FUQI PER LICENCAT, AUTORIZIMET DHE LEJET NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE

Kreu II Neni 9 Detyrime te krijuesit te mbetjeve

Neni 12 Perpunimi dhe asgjесimi i mbetjeve te ndertimit

Neni 24/1

Neni 25 Lejet mjedisore

Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licensën profesionale nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) Kodi III.2.B.

2.3.9. Certifikat ISO:

- a) ISO 9001-2015 – Standard per Sistemin e Menaxhimit te Cilesise (e vlefshme) ose ekuivalente, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i*

akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

- b.* **OHSAS 18001-2007 ose ekuivalenten e saj ISO 45001-2018 Standart per Menaxhimin e Shendetit dhe Sigurise ne Pune (e vlefshme) ose ekuivalente, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.**

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 8.*(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)***FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik
 _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

PJESA I: A. INFORMACION NË LIDHJE ME OPERATORIN EKONOMIK

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- ---

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:			
<ul style="list-style-type: none"> Informacione për nënkontraktorin 			
Emri i nënkontraktor	NIPT –	Përqindja e	Punët/ pajisjet e lidhura me to për

it të propozuar	i	nënkontraktimit	t'u nënkontraktuar

• Informacion mbi subjektet, mbi kapacitetin e, të cilave do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Deklaroj se, për subjektin / subjektet në kapacitetin/et, e të cilit/ëve do të mbështetem, nuk ka arsye për skualifikimin ose përjashtimin e tij / tyre nga procedura, në përputhje me dispozitat e nenit 76 të LPP-së, dhe konfirmoj me dokumente provuese që do të ketë burimet e kërkuara siç janë deklaruar.

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata	Referencat (kur janë të zbatueshme)
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentacit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni]

<p>data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p>	<p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p> <hr/> <hr/> <p>etj.</p> <p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjisllacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>

<p>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.</p> <p>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi, përfshirë legjislacionin mjedisor, social dhe të punës.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.</p> <p>Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>

B: DEKLARATA Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, bëj këtë deklaratë në përputhje me nenin 1 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", dhe në zbatim të Ligjit Nr. 9121/2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", dhe garantoj që deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:	
1. Kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj deklarate;	Po []
2. Kuptoj që oferta e paraqitur do të skualifikohet dhe / ose përjashtohet nga pjesëmarrja në prokurimin publik nëse kjo Deklaratë konstatohet se nuk është e plotë dhe / ose e pasaktë në të gjitha aspektet;	Po []
3. Jam i autorizuar nga Ofertuesi për të nënshkruar këtë Deklaratë dhe për të paraqitur një Ofertë në emër të Ofertuesit;	Po []
4. Çdo person, nënshkrimi i të cilit paraqitet në dokumentacionin e ofertës është i autorizuar nga ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në emër të ofertuesit;	Po []
5. Për efekt të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë e kuptoj se fjala "konkurrent" nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, përveç Ofertuesit, pavarësisht nëse paraqitet si një bashkim i operatorëve ekonomikë ose jo, që: a) paraqet një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës të bërë nga Autoriteti/Enti Kontraktor; b) është ofertues i mundshëm i cili, bazuar në kualifikimet, aftësitë ose përvojat e tij, mund të paraqesë një Ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës .	Po []
